



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD MITROVICA – BASIC COURT OF MITROVICA

P.nr.131/2017

NË EMER TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE Departamenti i përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gëzim Ademi ne çështjen penale, ndaj te pandehurit D.R nga ... rruga “...”, për shkak te veprave penale : **Kanosje nga neni 185 par.2 te KPRK-ës**, si dhe për veprën penale **Asgjësimit apo dëmtimit i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-ës e ne bashkim real me piken I te dispozitivit** sipas Aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë PP.II.nr.23/2017 te datës 02.03.2017, pas mbajtjes se shqyrtimit gjyqësor me dt.25.06.2019, ne mungese te prokurorit e ne prezence te pandehures me datën 25.06.2019, e beri shpalljen ndërsa me datë 27.06.2019, merre këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura: D.R, nga i ati **K.**, e ëma **B.**, e vajzërisë **M.**, e lindur me ... me vendbanim ne ... rruga “...”, me nr. Personal ..., ka kryer fakultetin, e pa martuar, e gjendjes se mesme ekonomike, Shqiptare, Shtetase e Republikës se Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

SEPSE:

I Me datën 27.09.2016 rreth orës 18:20, ne ... ne rrugën ‘...’, para dyerve te shtëpisë se saja me qellim te frikësimit dhe shkaktimit te ankthit e kanos seriozisht te dëmtuarën L.H e cila kishte shkuar tek shtëpia e te pandehurës rreth sqarimit te një mosmarrëveshje qe kishin pasur rreth një lidhje dashurie me te njëjtin person, ashtu qëkur e pandehura ka dale nga shtëpia me një thike te vogël te kuqe ne dore dhe kur e ka pare veturën BMW X5 te ndalur para dyerve te shtëpisë se saj ne te cilën L. i afrohet veturës dhe deri sa xhami i veturës ka qene gjysme i hapur, e pandehura i fut dorën brenda veturës e shkul për flokëve te dëmtuarën L. duke i thënë ‘kam me te mbyte’ por e dëmtuara arrin me mbyll xhamin dhe ne ato momente familjaret e te pandehurës mundohen ta largojnë por ajo edhe atëherë vazhdon me fjalët “me lejoni se pa e mbyt këtë kurvë se la”.

Me këtë ka kryer veprën penale- **Kanosje nga neni 185 par.2 te KPRK-ës**

II-Në te njëjtën dite kohe dhe vend si ne piken I te këtij dispozitivit duke qene e frustruar nga e dëmtuara dhe ne gjendje agresive e ka dëmtuar pasurinë e personit tjetër ashtu qe me thikën qe kishte ne dore dhe atë me dorezën e thikës ka goditur xhamin e veturës nga ana e ngasësit duke e grithur pastaj me thike arrin ti shpoj edhe dy gomat e veturës derisa te njëjtën e kanë

larguar nena, motra dhe nje fqinje e saje duke i shkaktuara dem material ne veturën “BMW X5” te dëmtuarës L.H.

Me këtë ka kryer veprën penale-**Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-ës e ne bashkim real me piken I te dispozitivit.**

Andaj gjykata ne mbështetje te nenit 4,7,8,9,10,41,46,49,50,51,52,73 neni 185 par 2 te KPRK-ës si dhe neni 333 par.1 i KPRK-ës dhe nenit 365, 450,463 te KPP-ës:

G J Y K O N

Për veprën penale si ne piken I te dispozitivit te aktakuzës, **ME DENIM ME GJOBE NE SHUME prej 300 (treqind) euro,**

Për veprën penale si ne piken II te dispozitivit te aktakuzës **ME DENIM ME BURG ne kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve** i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale ne kohëzgjatje prej 1 një viti.

Nëse e akuzuara nuk e paguan gjobën në afatin e cekur, Gjukata do të veproj në bazë të nenit 46 të KPRK -ës deri zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 20 euro (njëzet) euro për një ditë të kaluar ne burg.

OBLIGOHET i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve procedurale- paushallin gjyqësor te paguaj shumen prej 30 (tridhjetë) euro, për fondin e kompensimit te viktimave te krimin shumen prej 30 euro, te gjitha këto është i obliguar qe ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike-kompensimin e demit udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.23/2017 te datës 02.03.2017, kundër te pandehurës D.R nga ... rruga "...", për shkak të veprave penale **Kanosje nga neni 185 par.2 te KPRK-ës** si dhe te veprës **Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-ës e ne bashkim real me piken I te dispozitivit.**

Gjukata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor me dt.25.06.2019, ashtu qe ne këtë seance e pandehura lidhur me fajësinë ka deklaruar: se e ndjej veten fajtor për veprat penale qe me vihen ne barre, dhe njëherit me vjen keq për rastin qe ka ndodhur sa qe nuk dua as ta kujtoj, njëkohësisht edhe jam penduar për rastin qe ka ndodhur, ka qene aty për aty dhe nuk kam mundur ta kontrolloj veten, asnjëherë ne jetën time nuk e kam shkelur ligjin.

Lidhur me pranimin e fajësisë prokurori deklaroi: e pranojmë pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurës nga se i njëjti është i vullnetshëm dhe pa presion dhe bazohet ne provat qe gjenden ne shkresat e lendes e me rastin shqiptimit te dënimit pranimin e fajësisë gjykata e merr si rrethane lehtësuese.

Vlerësimi i pranimit të fajësisë.

Gjykata duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka gjetur se pranimi i fajësisë ishte në përputhje me neni 248 pasi që i pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, se pranimin e fajësisë i pandehuri e bënë në mënyrë vullnetare, pas sqarimeve të mjaftueshme nga ana e Gjykatës, se aktakuza nuk përmban shkelje të qarte ligjore apo gabime faktike që do të bënin të pamundur që gjykata të bëjë vlerësimin e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë nga i pandehuri është i mbështetur në faktet e çështjes që përmban akuza, të gjitha këto për gjykatën përveç se vërtetojnë faktet e çështjes se akuzës njëkohësisht janë në përputhje me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, prandaj edhe gjykata e ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit, këto rrethana vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndes si: Shkresat e policisë sipas nr. të rastit ... të dt 02.10.2016, raporti i oficerit i dt.28.09.2016, shënimet zyrtare të dt. 19.04.2016 dhe 06.10.2016, vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve i dt.29.09.2016, raport mbi deklarinë e rastit në polici me dt.27.09.2016, foto dokumentacionin si dhe shkresat e tjera të lëndes nga të gjitha këto si dhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit vërtetohet se e pandehura i ka kryer veprat penale: **Kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK-ës, si dhe Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-ës e në bashkim real me piken I të dispozitivit.**

Vlerësimi lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh se vepra penale Kanosje nga neni 185 par.2 të KPRK-ës, është e dënueshme me dënim me gjobe ose me burgim deri në 1(një) vit, ndërsa vepra penale Asgjësim apo dëmtim i pasurisë nga neni 333 par.1 i KPRK-ës e në bashkim real me piken I të dispozitivit, është e dënueshme me burgim deri në 1(një) vit, andaj duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale rrethanat në të cilat ishte kryer vepra penale. Si rrethane lehtësuese gjykata ka gjetur rrethanat personale të kryerësit dhe sjelljen e saj pas kryerjes së veprës penale, gjykata ka vlerësuar si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë e që nga deklarimi i saj me rastin e pranimit të fajësisë e njëjta deklaroi se e ndien veten fajtor ky deklarim i tillë i të pandehurës për gjykatën shpreh një pendim të thellë të tij për veprën penale. Po ashtu si rrethane lehtësuese gjykata ka marrë faktin se e pandehura kishte ra ndesh me ligjin për here të parë Nga të gjitha këto gjykata duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurës pasi që për gjykatën në rrethana të tilla mjafton dënimi me kusht dhe me gjobe, nga se do të ndalojë kryerësin që të mos kryej vepra penale në të ardhmen e që ky është edhe qëllimi i dënimit. Nga të gjitha këto rrethana kjo gjykatë vlerëson se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit ndaj të pandehurit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës penale.

Lidhur me shpenzimet procedurale- paushallin gjyqësor gjykata ka obliguar të pandehurën që të paguaj shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, si dhe në emër të fondit

për kompensimin e viktimave shumen prej 30(tridhjetë) Euro te gjitha këto është i obliguar që ti paguaj ne afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Për sa i përket kërkesës pasurore-juridike gjykata te dëmtuarit i ka udhëzuar ne konteste te rregullt civil.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 248, 365, 450,463 te KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P. nr.131/2017 dt.27.06.2019

Procesmbajtësja :
Hasnije Muhaxheri

Gjyqtari :
Gëzim Ademi

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kane te drejte ne ankese ne afat prej 15 ditëve ne gjykatën e Apelit ne Prishtine, nëpërmes kësaj gjykate